REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

KOMISIONI I BUXHETIT, FINANCËS DHE TAKSAVE-TARIFAVE

Datë 5.10.2026

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Projekt-vendimin *(titulli i projektvendimit)*: **PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 33.211.047 (TRIDHJETË E TRE MILIONË E DYQIND E NJËMBËDHJETË MIJË E DYZET E SHTATË) LEKË NGA BUXHETI I BASHKISË DURRËS PËR BASHKËFINANCIMIN NË MASËN 50% ME MINISTRINË E EKONOMISË DHE INOVACIONIT PËR SUBVENCIONIMIN E QIRASË PËR VITIN 2026, PËR FAMILJET QË PËRMBUSHIN KRITERET LIGJORE PËR PËRFITIMIN E BONUSIT TË STREHIMIT**

Baza ligjore:

Në zbatim të ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Ligjit nr.22/2018 "Për strehimin social", i ndryshuar, VKM-së nr. 1093, datë 28.12.2015 "Për miratimin e procedurave, kritereve dhe përparësive për dhënien e bonusit të strehimit", VKM-së nr.574, datë 29.08.2012 "Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për t'u strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve e të proçedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore", VKM-së nr. 814, datë 03.12.2004 "Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit", VKM-së nr. 362, datë 29.05.2019 "Për kriteret e dhënies së suvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në suvencionimin e qirasë në tregun e lirë , nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij" , Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 459, datë 03.07.2019 "Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufruktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe Ministrisë përgjegjës për strehim", Udhëzimit nr. 31, datë 18.11.2019, "Për procedurat standarde të aplikimit dhe kriteret për përftitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit", Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.73 datë 23.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm 2026-2028", Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.44 datë 09.07.2026 "Për për miratimin e ndryshimit të VKB-së nr. 7, datë 10.02.2026 "Për miratimin e listës emërore të familjeve që përmbushin kriteret ligjore për përfitimin e bonusit të strehimit që do të akordohet nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit në favor të Bashkisë Durrës për subvencionimin e qirasë për vitin 2026", sipas përgjigjes së ardhur nëpërmjet postës elektronike më datë 02.10.2026 nga Ministria e Ekonomisë dhe

Inovacionit, e cila konfirmon se financimi nga Buxheti i Shtetit, sipas kategorisë së të ardhurave për frymë në të cilën përfshihet Bashkia Durrës, mbulon 50% të vlerës së programit, e për rrjedhojë, Bashkia Durrës duhet të sigurojë bashkëfinancimin në masën deri në 50% të vlerës së programit.

Propozimi nga kryetari/këshilltarët/tjetër *(Çfarë propozohet në projektvendim):*

Kryetari i bashkisë, sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale, i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë konform akteve ligjore dhe të vendosë:

1. Miratimin e përdorimit të fondit prej 33.211.047 (tridhjetë e tre milionë e dyqind e njëmbëdhjetë mijë e dyzet e shtatë lekë) Lekë me qëllim subvencionimin e bonusit të qirasë në masën 50% në bashkëfinancim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit për familjet në vështirësi ekonomike që përfitojnë bonus për strehim për vitin 2026.

2. Fondi prej 33.211.047 (tridhjetë e tre milionë e dyqind e njëmbëdhjetë mijë e dyzet e shtatë lekë) Lekë që do të përdoret për subvencionimin e bonusit të qirasë të merret nga fondi rezervë i planifikuar në buxhetin e vitit 2026, sipas VKB-në nr.73 datë datë 23.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm 2026-2028".

3. Ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit për zbatimin e këtij vendimi.

Analiza Financiare/ Buxheti total/natyra e financimit (të ardhurat e veta, transferta etj):

Buxheti i bashkisë 2027.

Drejtoria/Sektori përgjegjës që ka përgatitur materialin:

Drejtoria e Shërbimeve Sociale.

Impakti social/grupet që preken:

Banorët e Bashkisë Durrës.

A është objekt konsultimi: *(PO/JO)*

JO.

Komisioni i përhershëm/përkohshëm i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave, u mblodhë më datë 5.10.2026, dhe shqyrtoi pikën nr. 4 të rendit të ditës, relacionin dhe dokumentat shoqërues të tij.

Komunikimi midis administratës dhe komisionit i përhershëm/përkohshëm:

Kryetari i komisionit: Nuk ndodhet.
Pyetën anëtarët e komisionit nëse kanë pyetje:
Të fillojë jeni dakord që të jetë [illegible]

mbledhjen e datës 6.10.2016.

Për sa më sipër, pas shqyrtimit, të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni me shumicë votash, vendosi:

T'i propozojnë Këshillit Bashkiak:

a- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim
b- Miratimin e projekt aktit
c- Refuzimin e miratimit të projektaktit
d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si vijon:
e- _____

Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave

Kryetar	Rolant Xhelilaj
Zv/Kryetar	Erzen Laçi
Sekretar	Hekuran Markola
Anëtar	Jonada Mamo
Anëtar	Alfred Mullaraj
Anëtar	Kastriot Xhongoli
Anëtar	Silvana Agasi
Anëtar	Dritan Burgija
Anëtar	Jonuz Myshketa
Anëtar	Xhojana Gjineci
Anëtar	Kontjana Kuçi